

Masa Gorog

Realitetet tona

(radiodramë e shkurtër)

Personazhet:

Piteri— student ambientalist, idealist (zemërmirë, jo hakmarrës, po pak nevrrik. Piteri në moshë të re kërkon ende veten, nuk ka vetëbesim.)

Rolandi— i suksesshëm, student i pëlqyer nga të tjerët dhe sportist elitar (kjo e bën mendjemadh, por, edhe pse është arrogant, nuk është i keq si njeri)

Igazi— Person virtual krijuar nga Piteri, influencues në një rrjet të suksesshëm shoqëror

Laura —E dashura aktuale e Piterit dhe shoqja e tij e kolegjit

Feliksi- shok i Piterit

Realiteti Virtual (RV) - zë reklamash marketingu; zë femëror joshës, si nina-nanë, zëri fishkëllyes dhe magjepsës i parajsës (ngjason me zërin e Kasë, gjarpri që hipnotizon Moglin te filmi i Walt-Disney-t)

Një zë i brendshëm - zëri i Piterit, zë mashkulli i qetë, i qëndrueshëm. Nuk është gjykues.

Protagonisti - **Piteri**— zhvillohet si personazh gjë që portretizohet nga zëri i aktorit në çdo skenë. I njëjti aktor luan si Piterin e ri, ashtu dhe atë në kolegji.

Si në të gjitha veprat, ka personazhe dytësore, funksioni i të cilëve është t'i japin mundësinë personazhit kryesor të thotë gjëra të caktuara, të kuptojë e të zgjidhë situata. Ndaj, zhvillimi i karakterit të tyre nuk ndiqet.

Emrat e personazheve nuk janë të pandryshueshëm. Çdo vend mund të përdorë emra që identifikohen lehtësisht me studentët e tij. Vetëm emri “Igaz” duhet të mbetet i pandryshuar (në anglisht, në çdo gjuhë).

Piteri është në shtëpi, po punon në kompjuter, fërshëllen, një muzikë e këndshme luhet në kompjuter (e ndjek me fërshëllimë), pastaj dëgjohet tringëllima e një mesazhi. Muzika vazhdon edhe pak sekonda, po Piteri ndalet pas tringëllimës.

Piteri: Pa shih!... si t’ia bëj me këtë? Nëse është e vërtetë, po ta postoj, e shkatërroj Rolandin njëherë e mirë. Karriera i merr fund. Burimi duket i besueshëm. Por Rolandi është vërtet sportist i mirë. Një idhull. E mori dreqi! Me “substancë të ndaluara”? Seriozisht? Nuk më besohet. (ndalet të mbushet me frymë) Zot i madh! Të mendosh sa e urreja dikur. Çfarë nuk do të kisha dhënë atëherë të më binte në dorë kjo! Do ta bëja publike pa e menduar dy herë. (mendueshëm) E megjithatë, nuk do të isha ky që jam sot pa Rolandin. (rikthehet muzika e këndshme)

(Të gjitha fjalët me shkronja kursive, si më poshtë, thuhën nga zëri femëror magjepsës – imagjinoni një reklamë për parajsën.)

RV: Eja në realitetin virtual! Realiteti virtual është gati që të hysh! Ji kushdo që dëshiron të jesh! Krijojë vetë realitetin tënd.

2. Gjimnazi ku studionin Piteri dhe Rolandi. Janë 16-vjeçarë dhe personalitetet e tyre janë ende të pazhvilluar plotësisht. Nuk shkojnë shumë mirë bashkë, por marrëdhënia e tyre nuk është armiqësore. Rolandi mbahet me të madh dhe Piteri e duron nga e keqja.

Dëgjohet një fërshëllimë dhe tinguj shishesh plastike që bien përtokë.

Piteri: Dreqin!

Rolandi: Po kjo? Nuk mban dot as një dorë plehrash plastike bosh! Goxha djalë i fuqishëm je! Ngriji, pra. Ngriji, Piter! (Rolandi qëllon me shkëlqim një shishe) Mos, djema! Gooooo! Sa keq! Ajo do të na shpëtonte planetin! (brohoritje tallëse, të qeshura)

Piteri: Kujdes, Roland! Do të pendohesh! (i fyer, i zemëruar, po pa e ngritur zërin)

Rolandi: Do pendohem...! Po, po! Aty mbahu! Mos u bëj më budalla nga ç'je! (të qeshura)

Rolandi dhe shokët e tij vazhdojnë rrugën, zërat e tyre vijnë duke u ulur, ndërsa i bien ziles së derës. Tingulli i ziles së shkollës, që shkrihet ngadalë në muzikë.

RV: Realiteti virtual- më e mira e botëve! S'të pëlqen realiteti? Krijë një tjetër. S'të pëlqen vetja? Bëhu cilido që dëshiron të jesh!

Piteri: Ashtu do të bëj! Do të krijoj një profil për veten, që do të bëjë namin. Do të habiten kur ta marrin vesh që jam unë! Jo se do ta marrin dot vesh ndonjëherë! Ky do të jetë sekreti im! Bota ime më e mirë! (pauzë)Po! Emri më i mirë është ai i kërkuesit të së vërtetës. Unë do të bëhem "Igazi" – një gazetar i famshëm! Do t'i krijoj vetes një të shkuar dhe një të tashme të re. Do të ngre një të ardhme. Askush nuk do të mund të tallet a të qeshë më me mua!

Zëri i brendshëm (mashkull): Kujdes, se do të përfundosh si Xhokeri!

Piteri: Jo, do të bëhem Batmani. Një Batman i përkryer, virtual. Një paladin i vërtetë ligji, por virtual.

Rreth 2 vjet më vonë. Piteri është student. Faqja që ka krijuar është popullore, po askush nuk e di kush është pas saj, cili është në të vërtetë Igazi.

Piteri ka shkuar në një bar për të ndenjur me shokët e tij. Trokitje gotash dhe biseda në sfond.

Laura: E patë postimin e Igazit për Rolandin? Mori fund. S'më besohet që merrte doping. Dukej kaq i paparë. Nëse është e vërtetë, do të përjashtohet nga klubi. Dhe nuk do marrë pjesë as në kampionatin botëror.

Feliksi: Po të mos ishte e vërtetë, Igazi nuk do ta kishte nxjerrë. Igazi nuk gënjen kurrë. Piter? Si thua ti?

Piteri: (hëm)Hiçgjë. Kam qenë në gjimnaz me Rolandin, por s'ishim fort miq. S'e duroja dot arrogancën e tij. I acaronte të gjithë, kurse mua më përçmonte mbi të tjerët.

Laura: Pse?

Piteri: E po, se isha pak si i ngathët, sipas tij... Dhe mbase kishte të drejtë. Po pa dyshim që donte të më përulte edhe para Endit që e dashuroja. Kështu që nuk shkonim fort mirë.

.

Feliksi: Po ç'mendon se ka ndodhur? Të ketë përdorur vërtet "substancë të ndaluara"?

Piteri: Në cilin realitet?

Laura: Si? Sa realitete mendon se janë?

Zëri i muzikës vjen duke u rritur...

VR: Kjo botë është më e mira e botëve. A e di sa botë ka? Sa vete kemi në sa botë? Sa jetë kemi në sa vete? Sa botë krijon për veten?

Muzika vjen duke u ulur. Rikthehen zhurmat e barit.

Feliksi: Shiko, nuk e besoj! Kam dëgjuar se Igazi do të hakmerret ndaj Rolandit dhe se bën vetë drogë. E keni dëgjuar këtë? Sapo the që Rolandin e ke pasur në shkollë... po mos ke pasur edhe Igazin?

Piteri: Si?

Laura: Hej, mbase e njeh lgazin?

Piteri: (duke murmuritur) Askush s'e njeh atë.

Feliksi: Të jetë shpërndarës thua? Mos sillte dhe shpërndante drogë?

Piteri: (befas i nxehur) Seriozisht e ke? S'kam provuar kurrë.... (ndërgjegjësohet për atë që tha) Dua të them, s'besoj se lgazi...

Laura: (nuk i besohet, e tronditur) Tiiiiiiii....? Je lgazi.....?

Prapë muzikë, po pak më e shpejtë

RV: Realiteti më i mirë virtual për ty! Do që të jesh ashtu si dëshiron të jesh? Të krijosh realitetin tënd? Mos lër askënd të të shkëpusë nga realiteti yt i përkryer.

Piteri: Unë, unë, unë...

.

Laura: (me zë të ulët, e zhgënjyer dhe përçmuese) Cili je ti, dreqin? Kush je në të vërtetë? S'dua të ta shoh më bojën.

Piteri: - Unë, unë, unë...

Muzika vijon

RV: A u përket të gjithëve virtualja? Mundësive që ke mund t'u vërë fre vetëm fantazia jote... Kush je ti? Ku ndodhesh? Çfarë je?

Bie zilja e alarmit dhe ndiqet nga një zë pajisjeje.

Zilja e orës: Mirëmëngjes, ora është 06:10 e mëngjesit.

Piteri: - Unë, unë, unë...

Zëri i Laurës: (gëzueshëm) Mirëmëngjes! (pak si me mëdyshje) Hej, çfarë ke? Si e ke hallin?

Piteri: Oh, dreqin! S'ta them dot.

Laura:Si?

Piteri: (Duke murmuritur me vete) S'ta them dot. Mbase dua të jetë e vërtetë?

Laura:Si?

Piteri: (i çliruar, duke ardhur në vete) Ti? Këtu? Mos po ëndërroja? Po... sa mirë, që nuk është realiteti! Apo ky është realiteti i ëndrrës?

Laura:Ç'po flet? Ç'realitet i ëndrrës? Ka vetëm një realitet dhe është ky këtu. (duke buzëqeshur, me ton të dashur e qetësues)Jam unë.

Piteri: (duke u menduar)Kush e di cila është e vërteta? Kush e di cili është realiteti?

Laura:Ç'po thua? Ç'realitet?

Piteri: Ç'realitet? Realiteti i kujt? E vërteta e kujt?... (duke i shkundur mendimet, gëzueshëm) Kryesorja është që tani je me mua. Këtu, tani. (duke buzëqeshur) Hëm... dhe kafeja qenka shumë e shijshme!

Dëgjojmë përzierjen e kafesë dhe pëshpëritje intimitetesh, ndërsa fillon muzika.

RV: (Luhet muzikë futuriste, që vazhdon edhe gjatë tekstit)

Zgjidh realitetin tënd! Portat e realitetit virtual të presin hapur 24 orë në ditë. Hyr brenda... Bëhu cilido që dëshiron të jesh... S'të pëlqen realiteti yt? Krijë një tjetër! Krijë realitetin tënd... Realiteti yt... Zgjedhja jote...(zëri meket, mbytet nga muzika.)

Komente të autorit për vënësit në skenë:

Radiodrama “Realitetet tona” flet për rrafshet e ndryshme të realitetit, që ekzistojnë në jetët tona. Rrafshet e kohës, virtualitetit, ëndrrës, mendimit dhe ekzistencës fizike. Këto rrafshet ndërveprojnë në jetët tona të përditshme.

Në radiodramë nuk ka qëllimisht heronj të mirë e të këqij. Personazhet janë të pëlqyeshëm (mua më pëlqejnë të gjithë). Janë të rinj që kërkojnë veten, që çajnë para me vendime që shërbejnë si piketa për hapat e ardhshëm. Janë njerëz që marrin vendime të drejta e të gabuara. Kohështrirja është edhe rrafshi i zhvillimit të personazheve. Ashtu si në jetë, na jep mundësinë të shohim pas dhe para dhe të pranojmë.

Tema nuk është hakmarrja. Në skenën e parë, Piteri beson se informacioni është i vërtetë. Kjo nuk do të thotë se nuk ndien kënaqësi, kur kujton ç’ka ngjarë, po ka edhe dyshime, pikërisht prej përvojave personale të së shkuarës. Ai nuk ka natyrë hakmarrëse, po ka një copë zemërimi, siç e kemi të gjithë. Prandaj, “do ta shkatërroj” është shtysë e mundshme, po mposhtet nga vendosja realiste e drejtësisë.

Radiodramatizimi nuk gjykon, vetëm prezanton. Është plot me pyetje e dyer të çelura për pedagogë e studentë. Ka shtigje e realitete që e çojnë historinë para, situata me të cilat mund të identifikohemi ose jo, apo për të cilat mund të reflektojmë.